

Kjo analizë paraqet një kronologji të ngjarjeve që lidhen me ndryshimin e dokumenteve personale pas ndryshimit të emrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2018; të dhëna statistikore mbi numrin e dokumenteve të marra nga qytetarët gjatë kësaj periudhe, si dhe të hyrat në buxhet të shtetit nga dokumentet personale të marra nga qytetarët gjatë kësaj periudhe.

HYRJE

Më 17 qershor të vitit 2018 u nënshkrua Marrëveshja e Prespës ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë. Mes tjerash, në këtë marrëveshje dypalëshe parashikohej edhe ndryshimi i emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga "Republika e Maqedonisë" në "Republika e Maqedonisë së Veriut", me çka qytetarët e Maqedonisë së Veriut do të duhej të paiseshin me dokumente të reja personale, pra me emrin e ri kushtetues të shtetit. Marrëveshja hyri në fuqi në shkurt të vitit 2019 dhe afati i fundit për ndryshimin e dokumenteve personale ishte shkurti i vitit 2024.

Edhe pse marrëveshja hyri në fuqi në shkurt të vitit 2019, lëshimi i dokumenteve personale të cilat përmbanin emrin e ri të shtetit filloi vetëm me 5 korrik të vitit 2021, pra rreth dy vite e pesë muaj nga hyrja e marrëveshjes në fuqi. Pra, dokumentet të cilat u morën nga qytetarët gjatë kësaj periudhe nuk do të vlenin pas shkurtit të vitit 2024 dhe do të duhej të ndryshohen meqë nuk përmbanin emrin e ri të shtetit, duke ngritur shumë pikëpyetje dhe reagime nga faktorë të ndryshëm mbi drejtësinë e këtij veprimi.

RETROSPEKTIVË

Zëdhënësi i atëhershëm i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, me datë 14 qershor të vitit 2018 deklaroi në një konferencë për media se sa i përket shpenzimeve, shpenzimet do të jenë shpenzime të rregulta për sigurimin e dokumentave, dhe se po punohet që qytetarët të mos ndiejnë asnjë kosto shtesë (1). Madje edhe Kryeministri i atëhershëm Zoran Zaev pati dhanë premtime që nuk do të dëmtohet xhepi i qytetarit nga ndryshimi i dokumenteve personale. Por se sa janë mbajtur këto premtime mbetet pikëpyetje e madhe. Përveç vonesës së dhënies së dokumenteve me emrin e ri të shtetit, çmimet nuk kanë mbetur të njëjta dhe pothuajse janë dyfishuar e trefishuar, kurse shërbimet kanë mbetur të njëjta, apo ndoshta edhe janë përkeqësuar si pasojë e mbingarkesës.


Në anën tjetër, pavarësisht premtive për digjitalizim dhe funksionimit të përmirësuar të administratës publike, procedura e ndryshimit të dokumenteve personale është shndërruar në një anktë për qytetarët.

PROGRESI I DERITANISHËM: TË DHËNAT ZYRTARE

Me datë 25 dhjetor 2023 Instituti IDEA ka dërguar një kërkesë për qasje në informacionet me karakter publik të cilën e kemi parashtruar në mënyrë elektronike deri tek Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë, së Veriut në të cilën e kemi pyetur për numrin e qytetarëve që kanë marrë dokumente personale siç janë pasaporta, letërnjoftimi dhe patent shoferi, me emrin e ri kushtetues të shtetit. Kërkesës tonë i janë përgjigjur më 15 janar të vitit 2024, duke na i dërguar të dhënat e kërkuara.

Siç mund të shihet në Figurën 1, prej datës 05 korrik 2021 deri më 31 dhjetor të viti 2023 1.168.466 qytetarë kanë marrë pasaporta të reja, 1.007.885 qytetarë kanë marrë letërnjoftime, dhe 529.858 qytetarë janë pajisur me patent shoferi.

Figura 1. Numri i qytetarëve që janë paisur me dokumente të reja në periudhën korrik 2021 - dhjetor 2023



NDRYSHIMI I DOKUMENTEVE PERSONALE: PËRFITIME NË KAOS?

RRITJA E ÇMIMEVE TË DOKUMENTAVE PERSONALE

Çmimet aktuale të paisjes me dokumente të reja personale janë paraqitur në Tabelën 1 më poshtë. Këto çmime paraqesin rritje të vazhdueshme të çmimeve gjatë periudhës së fundit. Rritja e fundit e çmimeve ndodhi në mars të vitit 2023. Për personat deri në moshën 27 vjeç, çmimi për pasaportë të re mbeti i njëjtë, ndërsa për personat mbi 27 vjeç ndryshoi. Çmimi i paisjes me pasaportë të re nga 1.500 denarë u rrit në 2.000 denarë, pra një rritje prej **33.33%**. Në anën tjetër, çmimi për letërnjoftim të ri nga 190 denarë u rrit në 310 denarë, që i bie një rritje **63.16%**; si dhe çmimi i patent-shoferit nga 280 denarë u rrit në 410 denarë, apo **46.43%** rritje të çmimit. Pra siç duket, duke e parë obligimin ligjor të ndryshimit të dokumenteve personale, Qeveria vendosi t'i rrisë çmimet në mënyrë arbitrare duke e shfrytëzuar mundësinë që të rrisë të ardhurat e buxhetit. Prandaj parashtrohet pyetja, a është kjo përfitim nga kaosi?!

Tabela 1. Çmimet për marrje të dokumenteve personale

Dokumenti	Mosha/procedura	Çmimi
Pasaportë	Deri në 27 vjeç	1.500 denarë
	Mbi 27 vjeç	2.000 denarë
	Procedurë e shpejtë	6.100 denarë
Letërnjoftim	Procedurë e rregullt	310 denarë
Patentë shoferi	Procedurë e rregullt	410 denarë
	Procedurë e shpejtë	1.230 denarë


SA TË HYRA KA REALIZUAR SHTETI NGA DHËNIA E DOKUMENTAVE TË REJA PERSONALE?

Ndryshimi i dokumenteve personale ka sjellur të hyra të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Prej pasaportave, në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë inkasuar përafërsisht **2.336.932.000 denarë** apo **38.122.871 euro** (pa ja shtuar kësaj faktin që shumë njerëz, e sidomos diaspora, kanë ndërruar pasaportat me procedurë të shpejtë, që nënkupton çmim trefish më i shtrejtë se ai me procedurë të rregullt).

Prej ndryshimit të letërnjoftimeve në buxhetin e shtetit qytetarët kanë lënë përafërsisht **312.444.350 denarë**, apo **5.096.971 euro**, ndërsa prej ndryshimit të patentave të shoferave shteti ka përfituar përafërsisht **217.241.780 denarë** apo **3.543.911 euro** (edhe këtu duke supozuar procedura të rregullta, pra më të lira).

Pra sipas përlogaritjes më lartë del që shteti nga ndryshimi i dokumenteve personale nga qytetarët që nga korriku i vitit 2021 deri më 31 dhjetor 2023 ka marrë më së paku **46.763.753 euro**.

Figura 2. Shumat e mbledhura nga shteti për secilin dokument (euro) në periudhën 2021-2023



Le të themi që nëse nga 2.097.319 qytetarë vetëm 1.168.466 kanë marrë pasaporta të reja, atëherë i bie që edhe 928.853 qytetarë do të duhen të paisen me pasaporta, që i bie plus **1.857.706.000 denarë** apo **30.206.602 euro** vetëm nga pasaportat. Nëse supozojmë dhe themi që letërnjoftime do të marrin edhe 500.000 qytetarë tjerë, atëherë buxhetit të shtetit i shtohen plus **155.000.000 denarë** apo **2.528.548 euro**.

NDRYSHIMI I DOKUMENTEVE PERSONALE: PËRFITIME NË KAOS?

Gjithashtu nëse themi që me patent shoferi janë paisur 529.858 qytetarë dhe do të paisen edhe 500.000 mijë të tjerë (megjithëse ky numër mund të jet edhe më i lartë) atëherë i bie që në buxhetin e shtetit do të grumbullohen plus **205.000.000 denarë** apo **3.344.208 euro**. Pra edhe tek këto shifra nuk përjashtohet mundësia që shumë njerëz i nxjerrin dokumentet me procedura të shpejta dhe këto shifra me probabilitet mund të jenë edhe më të larta sesa po themi ne.

PËRFUNDIM

- Tollovia e shkaktuar me rastin e ndryshimit të dokumenteve personale vuri në pah mungesën akute të digjitalizimit të proceseve bazike në Maqedoninë e Veriut ndërsa në anën tjetër shtoi barrën financiare dhe psikologjike për shumë familje dhe individë të cilët veçmë janë duke përjetuar gjendje të rëndë financiare si pasojë e çmimeve të larta dhe pagave që kanë stagnuar.
- Instituti IDEA vlerësojmë që përveç sporteve të stërngarkuara dhe tollovide nëpër institucione të ndryshme, me ndryshimin e dokumenteve personale shumë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ju është bërë padrejtësi dhe qytetarët janë dëmtuar në nivel të konsiderueshëm ndërsa institucionet e shtetit kanë bërë pak për ta lehtësuar këtë barrë edhe pse të hyrat nga ndryshimi i dokumenteve kanë qenë relativisht të larta.
- Gjatë ndryshimit së dokumentave personale është shkaktuar kaos i vërtetë; shumë qytetarë kanë pritur nga gjashtë muaj për termine, kurse muajin e fundit terminet nuk vlejnë më dhe qytetarët mund të fotografohen sipas rendit përpara kabinave ku mund të fotografohen. Kolonat kanë qenë dhe janë jashtëzakonisht shumë të gjata dhe aty ka pleq e fëmijë që po presin në këto ditë të ftohta dimri. Pikat shtesë dhe puna gjatë ditëve të diela përsëri nuk janë efektive në eliminim e krizës së krijuar.

Gjithashtu vlerësojmë që qytetarëve të cilët që nga shkurti i 2019 deri në korrik të 2021 kanë marrë dokumente të reja ju është bërë padrejtësi meqë për fajin e institucioneve të shtetit ato qytetarë do

të duhet të paguajn sërish për ndryshimin e dokumenteve personale edhe pse ato i kanë marrë para dy vitesh. Qeveria duhej të kishte konsideratë për këtë kategori të njerëzve dhe t'i lironte nga pagesa. Për këtë çështje ka reaguar edhe Avokati i Popullit i cili përmes një preskonference tha: *“Unë i jam drejtuar Qeverisë me apel që shpenzimet për përtëritjen e këtyre dokumenteve, për të gjithë qytetarët, të cilët pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese u janë dhënë dokumente me emrin Republika e Maqedonisë së Veriut, të jenë në ngarkesë të buxhetit të shtetit e jo të qytetarëve, sepse ato qytetarë që në këtë periudhë kanë nxjerrë dokumente personale, jo për fajin e tyre, kanë marrë pasaporta, letërnjoftime dhe dokumente tjera, të cilat shteti i shpall të pavlefshme që nga 24 shkurti i këtij viti. Fatkeqësisht Qeveria nuk e pranoi këtë rekomandim timin”*. Pra siç shihet ky apel i Avokatit të Popullit siç duket ra në vesh të shurdhër dhe qytetarët vazhdojnë ta mbajnë barrën.

Në momentin që kjo letër del në shtyp mbetet e paqartë si do të zhvillohet saga e ndryshimit të dokumenteve personale. Nga tentativa e Ministrisë të Punëve të Jashtme për ta shtyrë afatin e ndryshimit të dokumenteve personale nuk doli asgjë, meqë ky afat është i kushtëzuar me marrëveshje bilaterale. Pra siç duket qytetarët janë të destinuar të kalojnë një dimër nëpër sportelet e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

REKOMANDIME

- Të shtohen kapacitetet dhe resurset njerëzore brenda institucioneve të MPB-së në mënyrë që funksionimi të jetë më efikas dhe të evitohet kaosi.
- Të zgjatet orari i punës ose të mendohet për punë me dy ndrrime në MPB derisa qytetarët të paisen me dokumente.
- Të punohet intenzivisht në drejtim të digjitalizimit të procedurave në mënyrë që të shmanget prezenca fizike nëpër sportele.
- Të mendohet për kthim të mjeteve qytetarëve që kanë marrë dokumente personale brenda periudhës shkurt 2019–korrik 2021.